Paneli këshillëdhënës për të drejtat e njeriut
Building D, UNMIK HQ, Prishtinë/Kosovë | E-mail: hrap-unmik@un.org | Tel: +381 (0)38 504-604, ext. 5182

VENDIM

Data e miratimit: 10 qershor 2012

Lënda nr. 34/08

Desanka STANISHIÇ dhe Zoran STANISHIÇ

kundër

UNMIK-ut

Paneli Këshillëdhënës për të Drejtat e Njeriut, i mbledhur në qershor 2012,
me anëtarët vijues të pranishëm:

Z. Paul LEMMENS, Kryetar
Znj. Christine CHINKIN

Të ndihmuar nga
Z. Andrey ANTONOV, Zyrtar ekzekutiv

Pas shqyrtimit të ankesës së sipërpërmendur, të paraqitur në pajtim me nenin 1.2 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/12 të datës 23 mars 2006 për themelimin e Panelit Këshillëdhënës për të Drejtat e Njeriut,

Pas lajmërimit të tërheqjes së z. Marek Nowicki nga pjesëmarrja në këtë lëndë, në pajtim me Rregullën 12 të Rregullores së punës së Panelit,

Pas diskutimeve, vendosi si në vijim:

I. PROCEDURA PRANË PANELIT

1. Ankesa u paraqit më 21 gusht 2008 dhe u regjistrua më 17 shtator 2008.

2. Më 17 nëntor 2008, Paneli kërkoi nga përfaqësuesi i ankuesve të paraqesin informacione shtesë. Përfaqësuesi i tyre e ofroi përgjigjen më 4 dhjetor 2008.

3. Më 20 prill 2009, rasti iu komunikua Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm (PSSP), për komentet mbi pranueshmërinë e ankesës. PSSP-ja e paraqiti përgjigjen e UNMIK-ut më 11 maj 2009.

4. Më 23 shtator 2009, Paneli kërkoi informacione nga Agjencia Kosovare e Pronës (AKP). AKP-ja ofroi përgjigje më 28 shtator 2009.

5. Më 8 dhjetor 2009, Paneli ua komunikoi ankuesve përgjigjen e UNMIK-ut, duke i ftuar ata që të japin komentet e tyre dhe të sigurojnë informacione shtesë. Ankuesit e ofruan përgjigjen e tyre më 23 qershor 2010.

6. Më 23 qershor 2010, 3 tetor 2010, 14 tetor 2010, 5 nëntor 2010 dhe 15 nëntor 2010, ankuesit kanë dërguar një sërë dokumentesh në Panel.

7. Më 24 shkurt 2011, Paneli kërkoi informacione nga kryetari i gjykatës së qarkut në Prishtinë dhe nga kryetari i gjykatës komunale në Prishtinë.

8. Ankuesit i kanë dërguar dokumente shtesë Panelit më 8 mars 2011, 11 mars 2011, 14 mars 2011, 19 mars 2011 dhe 22 mars 2011.

9. Më 23 mars 2011, kryetari i gjykatës komunale të Prishtinës iu përgjigj kërkesës së Panelit për informacione. Më 31 maj 2011, Paneli kërkoi informacione shtesë. Kryetari iu përgjigj kërkesës më 14 qershor 2011.

10. Më 31 maj 2011, Paneli e përkujtoi kryetarin e gjykatë së qarkut në Prishtinë edhe njëherë. Kryetari u përgjigj më 25 korrik 2011.

11. Më 1 qershor 2011, Paneli kërkoi informacione shtesë nga ankuesit. Ankuesit iu përgjigjën kërkesës më 11 qershor 2011. Ata dërguan dokumente shtesë më 29 qershor 2011.

12. Më 18 janar 2012, Paneli kërkoi informacione nga Gjykata Supreme. Përgjigjen e mori më 19 janar 2012.

13. Më 9 mars 2012, Paneli kërkoi informacione shtesë nga AKP. AKP-ja iu përgjigj kërkesës të njëjtën ditë.

14. Ankuesit dërguan dokumente shtesë më 7 maj 2012.

15. Më 28 maj 2012, Paneli kërkoi informacione shtesë nga ankuesit. Ankuesit u përgjigjën më 5 qershor 2012.

II. FAKTET

A. Ngjarjet e vitit 1999

16. Ankuesit, znj. Desanka Stanishiç dhe djali i saj, z. Zoran Stanishiç, janë banorë të Kosovës të cilët kanë jetuar në Prishtinë, në një parcelë që ndodhej në mes të rrugës Miladin Popoviç dhe rrugës së Mariborit. Në atë tokë u ndërtuan dy ndërtesa: në anën e rrugës Miladin Popoviç, ishte një ndërtesë që përdorej për biznesin e kompanisë "Sigmakomerc Prishtina" ("Sigma commerce"), pronar i së cilës ishte z. Stanishiç; në anën e rrugës së Mariborit (por teknikisht me adresën e njëjtë sikurse lokalet afariste, përkatësisht rruga Miladin Popoviç), ndodhej shtëpia e familjes së ankuesve.

17. Në fund të qershorit 1999, z. Stanishiç shkoi në Serbi, për shkaqe sigurie. Znj. Stanishiç qëndroi në shtëpinë e familjes.

18. Sipas znj. Stanishiç, pas largimit të z. Stanishiç, ajo vërejti se një ish punëtor i Sigma commerce (z. A) filloi të sillej si drejtor, i ndihmuar nga dy burra të tjerë. Ajo vërejti se ata vidhnin sende nga lokalet e kompanisë.

Dikur më vonë, znj. Stanishiç e kishte vizituar z. A dhe dy pjesëtarë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK). Ata e shkatërruan lidhjen e telefonisë fikse në shtëpi,e kërcënuan atë dhe e urdhëruan që të mos largohej nga shtëpia. Pas gati dy javësh sa ajo kishte qëndruar në shtëpi, z. A, një burrë tjetër dhe dy pjesëtarët e njëjtë të UÇK-së erdhën sërish dhe e dëbuan atë nga shtëpia, e vendosën në një automjet, e dërguan deri në tregun e qytetit dhe e gjuajtën nga automjeti. Më pastaj atë e dërgoi një mik i familjes në pikën e kalimit kufitar në Merdare për në Serbi, nga ku e mori z. Stanishiç.

19. Sipas z. S Stanishiç, gjatë dy javëve kur nënës së tij nuk iu lejua të largohet nga shtëpia, atë e kishin kontaktuar disa herë z. A dhe persona të tjerë të cilët i bënin presion të shesë biznesin me një çmim të ulët, duke e kërcënuar atë se nëna e tij përndryshe do të vritej. Mirëpo, ai refuzoi që ta shesë biznesin.

20. Z. A, së bashku me persona të tjerë, filluan një biznes të ri, të llojit të njëjtë si Sigma commerce, në një lokacion tjetër. Sipas ankuesve, ata “vodhën” klientët nga Sigma. Lokalet afariste të Sigma commerce u uzurpuan ilegalisht nga persona të ndryshëm dhe me gjasë nga z. B, i cili e uzurpoi edhe shtëpinë.

B. Procedura pranë Drejtorisë për çështje banesore pronësore

Më 31 dhjetor 2001, znj. Stanishiç parashtroi kërkesë për riposedimin e shtëpisë në rrugën e Mariborit pranë Drejtorisë për çështje banesore pronësore (HPD).

21. Më 27 qershor 2003, Komisioni i ankesave për çështje banesore pronësore (HPCC) vendosi kërkesën në favor të saj dhe e urdhëroi të paditurin, z. B, të lirojë pronën. Z. Stanishiç e mori vendimin e HPCC më 10 shkurt 2004.

22. Meqë z. B pohohej se ishte kërcënuar të djegë dhe shkatërrojë pronën, znj. Stanishiç nuk ishte në gjendje ta merr në riposedim. Më 17 gusht 2004, ajo kërkoi nga HPD të merr pronën në fjalë nën administrimin e saj. Derisa e administronte pronën, HPD e lejoi z. B të qëndrojë në atë pronë.

23. Më 23 shkurt 2005, znj. Stanishiç kërkoi nga HPD të dëbojë z. B nga prona e saj. Ajo e përkujtoi HPD-në për këtë më 28 prill 2005. Më 10 maj 2005, ajo e nënshkroi formularin e HPD-së me të cilin kërkoi dëbimin.

24. Një ditë para se të ekzekutohej dëbimi, z. B e lëshoi pronën dhe çelësat ia ktheu HPD-së. Më 27 qershor 2005, znj. Stanishiç i mori çelësat e kësaj prone.

25. Më 10 nëntor 2005, ankuesit u kthyen në pronën e tyre, të cilën e gjetën shumë të shkatërruar dhe të plaçkitur. Ata qëndrua aty për rreth gjashtë muaj, dhe gjatë kësaj periudhe ata e pastruan shtëpinë dhe rregulluan gjërat e domosdoshme bazike. Sipas ankuesve, lokalet e Sigma commerce ishin në gjendje të mjerueshme, dhe ata vlerësuan shpenzimet për riparimet e nevojshme të jenë përafërsisht 100,000 euro.

26. Meqë ata nuk kishin mundësi të sigurojnë mjetet e nevojshme financiare për riparimin e lokaleve komerciale dhe të rifillojnë aktivitetet e Sigma commerce, ankuesit me gjasë i lëshuan pronat e tyre dhe u kthyen në Serbi.

27. Siç duket, që atëherë, as ankuesit as ndonjë person tjetër nuk është vendosur në asnjërën nga këto prona.

C. Përfundimi i përgjegjësisë së UNMIK-ut për sa i përket gjyqësorit

28. Më 9 dhjetor 2008, përgjegjësia e UNMIK-ut lidhur me gjyqësorin në Kosovë përfundoi me marrjen e kontrollit të plotë operacional nga Misioni i Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë (EULEX) në fushën e sundimit të ligjit, pas deklaratës së bërë nga Kryetari i Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara më 26 nëntor 2008 (S/PRST/2008/44), duke përshëndetur angazhimin e vazhdueshëm të Bashkimit Evropian në Kosovë.

D. Procedura civile dhe penale e iniciuar para 9 dhjetorit 2008

1. Padi civile kundër komunës së Prishtinës, Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes në Kosovë dhe UNMIK-ut

29. Më 15 korrik 2004, znj. Stanishiç parashtroi kërkesë për kompensim të dëmit të shkaktuar shtëpisë së saj dhe objektit afarist në gjykatën komunale në Prishtinë, kundër komunës së Prishtinës dhe Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes në Kosovë (IPVQ).[1] Ajo kërkoi një shumë prej 295,000 eurosh. Gjatë procedurës kërkesa ishte ndryshuar për të përfshirë z. Stanishiç si ankues shtesë dhe UNMIK-un dhe KFOR-in si të paditur shtesë.

30. Më 23 nëntor 2006, gjykata komunale në Prishtinë konstatoi se UNMIK-u gëzonte imunitet nga juridiksioni lokal, dhe ankesën kundër UNMIK-ut e shpalli të papranueshme.

31. Më 19 dhjetor 2006, ankuesit parashtruan ankesë kundër këtij aktgjykimi të gjykatës së qarkut në Prishtinë.

32. Përderisa ankesa ishte drejtuar kundër komunës së Prishtinës dhe IPVQ-ve, gjykata komunale e Prishtinës konstatoi më 22 janar 2007 se të dy të paditurve u mungonte "legjitimiteti pasiv", dhe ankesën kundër tyre e shpallën po ashtu të papranueshme.

33. Më 13 shkurt 2007, ankuesit parashtruan ankesë kundër këtij aktgjykimi pranë gjykatës së qarkut në Prishtinë.[2] Sipas ankuesve, dosja ishte transferuar në gjykatën e qarkut më 25 qershor 2007.

34. Duke vendosur për këtë ankesë, më 11 shtator 2008 gjykata e qarkut ktheu mbrapsht aktgjykimin e gjykatës komunale të datës 22 janar 2007, dhe lëndën ia ktheu gjykatës për rishqyrtim. Gjykata e qarkut konstatoi se çështja e zotësisë për t'u paditur ishte një çështje që lidhej me bazueshmërinë e ankesës dhe jo pranueshmërinë e saj. Gjykata e qarkut e udhëzoi në mënyrë specifike gjykatën komunale që t'i ftojë ankuesit të specifikojnë palët e paditura dhe pastaj të vendosë për bazueshmërinë e rastit. Duket se aktgjykimi i 11 shtatorit 2008 e kishte edhe efektin e hedhjes poshtë të ankesës kundër aktgjykimit të gjykatës komunale të datës 23 nëntor 2006.

---

[1] Lënda nr. 2553/04.
[2] Lënda nr. Ac. 519/2007.

35. Në procedurën e kthimit të lëndës pranë gjykatës komunale të Prishtinës[3], ankuesit treguan se palët e paditura janë komuna e Prishtinës, Qeveria e Kosovës dhe UNMIK-u.

36. Më 12 janar 2009, gjykata komunale konstatoi se komuna e Prishtinës dhe Qeveria e Kosovës nuk kishin "legjitimitet pasiv", dhe ankesën e shpallën të pabazuar në këtë aspekt. Përderisa ankesa ishte e drejtuar kundër UNMIK-ut, gjykata konstatoi se nuk kishte juridiksion, duke ditur imunitetin e UNMIK-ut nga proceset ligjore.

37. Ankuesit parashtruan ankesë kundër këtij aktgjykimi pranë gjykatës së qarkut në Prishtinë.[4] Më 18 nëntor 2010, gjykata e qarkut e hodhi poshtë ankesën dhe e mbështeti vendimin e sipërpërmendur të gjykatës komunale.

38. Më 10 janar 2011, ankuesit parashtruan kërkesë për shqyrtim në Gjykatën Supreme.[5] Më 19 janar 2012, Gjykata Supreme e njoftoi Panelin se lënda e ankuesve akoma ishte në pritje për shqyrtim.

2. Kallëzimi penal lidhur me kidnapimin e znj. Stanishiç dhe shkeljet tjera

39. Në qershor të vitit 2006 ankuesit parashtruan kallëzim penal kundër z. A, z. B dhe z. C (babai i z. A) në Prokurorinë publike të qarkut në Prishtinë, duke pohuar vjedhje (në vitin 1999), kidnapim (të znj. Stanishiç në vitin 1999), dhe lidhur me shitjen e pronës së tyre në vitin 2005 ose 2006). Rastin ia kishin caktuar një prokuroreje publike ndërkombëtare.[6]

40. Pas shqyrtimit të pohimeve dhe zbatimit të disa veprimeve hetimore, më 15 shkurt 2007 prokurorja publike ndërkombëtar e hodhi poshtë kallëzimin penal. Për sa u përket pohimeve lidhur me vjedhjen dhe kërcënimet, ajo vendosi se për shkak të mungesës së dëshmive për këto pohime nuk kërkohej ndjekje penale. Sa u përket pohimeve për kidnapim, ajo e rikualifikoi shkeljen si mbajtje e paligjshme (neni 63 i Ligjit penal të Serbisë), dhe konkludoi se shkelja e tillë e kishte afatin e parashkrimit. Me këtë vendim udhëzoheshin ankuesit për të drejtën e tyre që të ndërmarrin procedura të mëtejshme si paditës subsidiarë, brenda tetë ditëve nga marrja e vendimit. Ky vendim u është dërguar ankuesve shpejt pas kësaj.

41. Me një shkresë të shënuar gabimisht datë "3 shkurt 2007", që e ka marrë Departamenti i Drejtësisë së UNMIK-ut më 1 mars 2007, ankuesit protestuan kundër këtij vendimi, dhe e njoftuan prokuroren ndërkombëtare për dëshirën e tyre që të ndërmarrin procedura të mëtejshme si paditës subsidiarë. Me shkresën e njëjtë ata kërkuan origjinalin apo një kopje të vërtetuar të dosjes së plotë të hetimeve. Nuk duket se ka pasur ndonjë reagim ndaj kësaj kërkese.

3. Kallëzimi penal kundër z. B, lidhur me uzurpimin e paligjshëm të pronës dhe kundërvajtjeve të tjera

42. Më 20 tetor 2008, z. Stanishiç parashtroi kallëzim penal në Prokurorinë publike të Prishtinës kundër z. B, për uzurpim të paligjshëm të pronës së paluajtshme, mashtrim dhe shkelje të statusit të barabartë të banorëve të Kosovës.[7]

---

[3] Lënda nr. 1728/08.
[4] Lënda nr. Ac. 393/09.
[5] Lënda nr. 159/2011.
[6] Lënda nr. PC 118/07.
[7] Lënda nr. KT 5154-11/2008.

43. Më 20 janar 2009, Prokurori publik komunal në Prishtinë e hodhi poshtë ankesën, mbi bazën se të gjitha aktet për të cilat ishte parashtruar ankesë kishin ndodhur në korrik të vitit 1999 dhe se ndjekja penale ishte e parashkruar. Me këtë vendim z. Stanishiç udhëzohej për të drejtën e tij që të ndërmerr procedurë të mëtejshme si paditës subsidiar, brenda tetë ditësh nga marrja e vendimit. Avokati i z. Stanishiç ka marrë një kopje të vendimit më 23 janar 2009.

44. Siç duket z. Stanishiç nuk ka vepruar sipas këtyre udhëzimeve.

4. Padia civile kundër z. B

45. Më 4 nëntor 2008, ankuesit parashtruan ankesë kundër z. B në gjykatën komunale në Prishtinë, për kompensim të dëmit shkaktuar pronës së tyre.[8]

46. Disa herë, ankuesit i shkruan kryetarit të gjykatës për mosaktivitetin e gjykatës në rastin e tyre. Paneli nuk është në dijeni për ndonjë përgjigje në këto ankesa.

47. Më 14 qershor 2011, kryetari i gjykatës komunale i konfirmoi Panelit se lënda akoma ishte në pritje pranë kësaj gjykate.

E. Procedura penale e iniciuar pas 9 dhjetorit 2008

48. Më 12 janar 2009, z. Stanishiç, si paditës subsidiar, parashtroi aktakuzë kundër z. A, z. B dhe z. C, në gjykatën e qarkut në Prishtinë, për kidnapimin e znj. Stanishiç.

49. Në seancën dëgjimore për konfirmim të aktakuzës, gjyqtari për konfirmim i gjykatës së qarkut në Prishtinë e rikualifikoi veprën penale të pohuar nga kidnapimi (neni 159 § 1 i Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës) në privim të paligjshëm të lirisë (neni 162 i Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës). Më 6 mars 2009, gjyqtari e dërgoi rastin për veprim të mëtejshëm në gjykatën komunale të Prishtinës, si gjykatë që ka kompetenca për veprën penale të rikualifikuar.[9]

50. Disa herë, z. Stanishiç ka kërkuar sqarime në gjykatën komunale të Prishtinës për gjendjen e procedurës dhe ishte ankuar për obstruksionet që i bëheshin drejtësisë.

51. Seanca e parë dëgjimore për konfirmim të aktakuzës u mbajt më 2 qershor 2010. Më vonë, ankuesit iu ankuan gjyqtarit për konfirmim se ata nuk kishin marrë përkthim në gjuhën serbe të procesverbalit të seancës dëgjimore.

52. Në një seancë tjetër dëgjimore për konfirmim të aktakuzës, më 21 qershor 2010, z. Stanishiç e ndryshoi aktakuzën, duke shtuar akuzën e kidnapimit (neni 159 § 1 i Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës) kundër të akuzuarit të njëjtë. Një dëgjim tjetër u mbajt më 6 shtator 2010, në të cilin dy nga tre të pandehurit ishin të pranishëm. Gjyqtari për konfirmim vendosi të shtyjë seancën dëgjimore por pa caktuar ndonjë datë të re. Më 22 shtator 2010 dhe 30 tetor 2010, z. Stanishiç u ankua në gjykatën komunale për mënyrën se si gjyqtari për konfirmim e kishte trajtuar rastin.

---

[8] Lënda nr. 2025/08.
[9] Lënda nr. KA-96/09.

53. Më 22 nëntor 2010 gjyqtari për konfirmim në gjykatën komunale mori aktvendim me të cilin aktakuzën e hodhi poshtë në tërësi, në pajtim me nenin 316 (1), pika 3 e Kodit të Përkohshëm të Procedurës Penale të Kosovës, meqë të dy akuzat (privimi i paligjshëm i lirisë dhe kidnapimi) ishin të parashkruara, e para më 30 qershor 2005, e dyta më 30 qershor 2009. Sipas ankuesit, avokati i tij mori një kopje të aktgjykimit më 2 shkurt 2011.

54. Më 7 shkurt 2011, z. Stanishiç parashtroi ankesë kundër këtij aktvendimi në gjykatën e qarkut në Prishtinë.[10]

55. Më 22 shkurt 2011, një panel prej tri gjyqtarësh i gjykatës së qarkut e hodhi poshtë ankesën si të pabazuar. Gjykata ishte e mendimit se vepra penale me të cilën ngarkohej i akuzuari ishte privim i paligjshëm i lirisë dhe jo kidnapim. Konstatoi se gjyqtari për konfirmim drejtësisht e kishte konstatuar se vepra penale ishte e parashkruar.

F. Ankesat dërguar organeve të ndryshme lidhur me procedurën e sipërpërmendur gjyqësore

56. Ankuesit i siguruan Panelit kopje të ankesave të ndryshme lidhur me procedurën e sipërpërmendur gjyqësore, që në mes tjerash u ishin dërguar kryetarëve të gjykatave relevante, Njësisë gjyqësore për inspektim në Departamentin e drejtësisë së UNMIK-ut, Ministrit të drejtësisë në Kosovë, zyrës së Këshillit disiplinor të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, Shefit të drejtësisë së EULEX-it, Ombudspersonit dhe Kryetarit të Kosovës.

57. Në këto ankesa ankuesit akuzojnë autoritetet gjyqësore për pengimin e drejtësisë, duke mos proceduar në mënyrë të kujdesshme me kërkesat dhe ankesat e tyre dhe duke mbrojtur personat të cilët ilegalisht e uzurpuan pronën e tyre dhe e shkatërruan atë kur duhej të largoheshin nga aty. Sipas ankuesve, duke vepruar kështu gjykatat bashkëpunojnë me mbrojtësit e individëve të përmendur, të cilët pohohet se mbajnë pozita të larta në institucionet e Kosovës.

58. Zyra e Këshillit disiplinor e Këshillit Gjyqësor të Kosovës e informoi z. Stanishiç për hedhjen poshtë të tri ankesave të tij. Më 22 mars 2012, kjo zyrë e informoi atë se hetimi disiplinor i një ankese të katërt kishte rezultuar me konstatimin e sjelljes joprofesionale të njërit prej gjyqtarëve të gjykatës komunale të Prishtinës.

III. ANKESA

59. Në aplikacionin e tyre të parë drejtuar Panelit, ankuesit ankohen për mungesën e mbrojtjes kundër uzurpimit të pronës së tyre. Në veçanti, ata ankohen për faktin se derisa prona ishte nën administrimin e HPD-së, HPD-ja e lejoi uzurpatorin, z. B, të vazhdojë me uzurpimin dhe shfrytëzimin e pronës. Ata po ashtu argumentojnë se, kur z. B më në fund ishte dëbuar, HPD nuk e kishte parandaluar atë që të mos e dëmtojë rëndë dhe vjedhë pronën. Meqë ankuesit nuk ishin në gjendje të rihapin Sigma commerce, ata thirren në shkelje të së drejtës së tyre për të punuar, të garantuar me nenin 6 të Konventës Ndërkombëtare për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore (KNDESK), vetëm dhe në kombinim me ndalimin e diskriminimit, të garantuar me nenin 2 § 2 të KNDESK. Paneli mendon se ankuesit gjithashtu mund të konsiderohet se thirren në shkelje të së drejtës për të respektuar pronën e tyre, të garantuar me nenin 1 të Protokollit nr. 1 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ), dhe në të

[10] Case no. Kv.br. 45/11.

drejtën për ekzekutim të aktvendimit të marrë në favor të tyre, të garantuar me nenin 6 § 1 të KEDNJ.

60. Në aplikacionin e tyre të parë drejtuar Panelit dhe në parashtresat e tyre të datës 4 dhjetor 2008 dhe 23 qershor 2010, ankuesit po ashtu ankohen për vonesën e procedurës lidhur me kërkesën e tyre kundër komunës së Prishtinës, IPVQ-ve dhe UNMIK-ut. Në këtë aspekt, ata thirren në shkelje të së drejtës së tyre për të marrë një vendim brenda një kohe të arsyeshme, të garantuar me nenin 6 § 1 të KEDNJ.

61. Në parashtresat e tyre të datës 4 dhjetor 2008, ankuesit po ashtu ankohen për aktvendimin e prokurores publike ndërkombëtare për kallëzimin e tyre penal kundër keqbërësve të panjohur. Ata argumentojnë se, për shkak të rikualifikimit të pasaktë dhe të anshëm të njërës nga shkeljet si mbajtje e paligjshme dhe jo kidnapim, duke çuar në konkludimin se shkelja ishte e parashkruar, hetimi i asaj shkelje ishte i paefektshëm. Ankuesit thirren në shkelje të së drejtës së tyre për hetim të paanshëm dhe efektiv, të garantuar me nenin 12 të Konventës kundër Torturës dhe Trajtimeve ose Dënimeve të tjera Mizore, Johumane apo Degraduese, dhe me nenin 2 të KEDNJ. Paneli konsideron se ankuesit gjithashtu duhet konsideruar se thirren në shkelje të së drejtës së z. Stanishiç për një mjet të efektshëm, të garantuar me nenin 13 të KEDNJ, në kombinim me të drejtën për të mos u trajtuar në mënyrë johumane apo degraduese, të garantuar me nenin 3 të KEDNJ, dhe me të drejtën për të respektuar lirinë e saj, të garantuar me nenin 5 të KEDNJ.

62. Në parashtresën e tyre të datës 23 qershor 2010, ankuesit ankohen për vështirësitë me të cilat janë përballur në procedurën lidhur me padinë e tyre civile kundër z. B. Sipas ankuesve, deri atëherë nuk ishte ndërmarrë asnjë veprim nga Gjykata komunale e Prishtinës. Ata mund të konsiderohet se thirren në të drejtën e tyre për të marrë një vendim brenda një kohe të arsyeshme, të garantuar me nenin 6 § 1 të KEDNJ.

63. Në parashtresën e tyre të datës 23 qershor 2010, ankuesit po ashtu ankohen për vështirësitë në të cilat kanë hasur në procedurën lidhur me aktakuzën kudër zotërinjve A, B dhe C. Sipas ankuesve, ka pasur vonesa të paarsyeshme dhe parregullsi procedurale. Ata mund të konsiderohet se thirren në shkelje të së drejtës së tyre në gjykim të drejtë dhe në marrjen e një vendimi brenda një kohe të arsyeshme, të garantuar me nenin 6 § 1 të KEDNJ.

Në të gjitha parashtresat e tyre drejtuar Panelit, duke filluar me aplikacionin fillestar, ankuesit përgjithësisht ankohen për marrëveshjen e fshehtë ndërmjet autoriteteve gjyqësore dhe ish udhëheqësve të UÇK-së, të cilët aktualisht mbajnë pozita të rëndësishme në institucionet e Kosovës, për të penguar ankuesit dhe familje të tjera të fuqishme serbe që të kthehen në pronat e tyre dhe të rifillojnë veprimtarinë e tyre afariste. Ankuesit mund të konsiderohet se thirren në shkelje të së drejtës së tyre në një tribunal të pavarur dhe të paanshëm, të garantuar me nenin 6 § 1 të KEDNJ, vetëm dhe në kombinim me ndalimin e diskriminimit, të garantuar me nenin 14 të KEDNJ.

IV. LIGJI

64. Para se të shqyrtohet rasti për bazueshmërinë e tij Paneli duhet të vendosë nëse do ta pranojë rastin, duke marrë parasysh kriteret për pranim të përcaktuara në nenet 1, 2 dhe

3 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/12 të datës 23 mars 2006 për themelimin e Panelit Këshillëdhënës për të Drejtat e Njeriut.

A. Ankesa lidhur me mungesën e mbrojtjes nga ana e Drejtorisë për çështje banesore pronësore kundër uzurpimit dhe dëmit të shkaktuar pronës së tyre

a) Parashtresat e palëve

65. Përderisa ankesa ka të bëjë me mosmbrojtjen kundër uzurpimit dhe dëmit të shkaktuar pronës së tyre, ankuesit në veçanti ankohen për implementimin joefikas nga HPD të vendimit të HPCC të marrë në favor të tyre. Në këtë aspekt, ata ankohen për faktin se, derisa prona ishte nën administrimin e HPD, HPD e lejoi uzurpatorin, z. B, të vazhdojë me uzurpimin dhe shfrytëzimin e pronës (shih § 22 lart), dhe se, kur z. B më në fund ishte dëbuar, HPD nuk e kishte ndaluar atë nga dëmtimi i rëndë dhe vjedhja e pronës (shih §§ 23-25 lart).

66. Meqë ankuesit nuk kishin mundësi të rihapin Sigma commerce, ata thirren në shkelje të së drejtës së tyre për punë, të garantuar me nenin 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore (KNDESK), vetëm dhe në kombinim me ndalimin e diskriminimit, të garantuar me nenin 2 § 2 të KNDESK. Siç u theksua më lart (§ 59), Paneli konsideron se ankuesit gjithashtu mund të konsiderohet se thirren në shkelje të së drejtës për të respektuar pronën e tyre, të garantuar me nenin 1 të Protokollit nr. 1 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ), dhe e drejta për ekzekutim të aktvendimit të marrë në favor të tyre, të garantuar me nenin 6 § 1 të KEDNJ.

67. PSSP-ja, duke parë se vendimi i HPCC nuk i është komunikuar atij, e rezervon të drejtën për të komentuar për pranueshmërinë dhe bazueshmërinë e kësaj pjese të ankesës.

b) Vlerësimi i Panelit

68. Paneli konsideron se duhet bërë dallim në mes të periudhës kur prona e ankuesve nuk ishte nën administrimin e HPD dhe periudhës gjatë së cilës ajo ishte nën administrimin e tillë. Znj. Stanishiç kërkoi nga HPD më 17 gusht 2004 që pronën ta merr nën administrimin e saj; ajo mbeti nën administrimin e HPD-së derisa ankuesit e morën pronën e tyre në riposedim, më 27 qershor 2005.

69. Sa i përket periudhës para administrimit nga HPD, Paneli përkujton se neni 2 i Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/12 i datës 23 mars 2006 për themelimin e Panelit Këshillëdhënës për të Drejtat e Njeriut parasheh që Paneli të ketë juridiksion për ankesat lidhur me shkeljet e pohuara të të drejtave të njeriut "që kishin ndodhur jo më herët se 23 prill 2005 apo që dalin nga faktet që kanë ndodhur para kësaj date dhe faktet e tilla paraqesin shkelje të vazhdueshme të të drejtave të njeriut". Për rrjedhojë, ngjarjet që ndodhën para 23 prillit 2005 përgjithësisht janë jashtë juridiksionit kohor të Panelit (*ratione temporis)*. Për aq sa ngjarjet e tilla kanë paraqitur një situatë që ka vazhduar, Paneli ka juridiksion për shqyrtimin e ankesave që kanë të bëjnë me atë situatë, por vetëm nëse situata ka vazhduar pas 23 prillit 2005**.**

70. Nga kjo rrjedh se situata para se HPD të merr përsipër administrimin e pronës së ankuesve është tërësisht jashtë juridiksionit kohor të Panelit (*ratione temporis)*.

71. Sa i përket periudhës gjatë administrimit të HPD-së, Paneli thekson se HPD e lejoi z. B të qëndrojë në atë pronë. Ky vendim e kishte bazën ligjore në nenet 12.4 dhe 12.5 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2000/60 të datës 31 tetor 2000 për ankesat mbi pronën banesore dhe në Rregulloren e punës dhe të dëshmive të Drejtorisë për çështje banesore pronësore, dhe Komisionin e ankesave për çështje banesore pronësore, në të cilat nene thuhet:

> "12.4 Drejtoria mund të jep leje të përkohshme për të marrë në shfrytëzim pronë nën administrimin e saj, sipas rregullave dhe kushteve që ajo i konsideron të përshtatshme. Lejet e përkohshme jepen për një periudhë të caktuar kohore por mund të ripërtëriten pas aplikimit.
> 12.5 Drejtoria cakton kriteret për ndarjen e pronave nën administrim në baza të përkohshme humanitare."

72. Përderisa situata ka ndodhur para 23 prillit 2005, është jashtë juridiksionit kohor të Panelit (*ratione temporis)* (shih §§ 69-70 lart).

73. Përderisa leja e dhënë z. B që të qëndrojë në atë pronë u vazhdua nga 23 prilli 2005 deri në datën kur ai e lëshoi pronën, d.m.th. diku në qershor 2005, Paneli konsideron se kjo leje përbënte ndërhyrje në të drejtën e ankuesve për respektimin e pronës së tyre, të garantuar me nenin 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ. Mirëpo, Paneli nuk konsideron se kjo ndërhyrje ishte një barrë e tepërt për ankuesit, duke pasur parasysh faktin se ata në çdo kohë, pasi të kenë mësuar për situatën, kanë mundur të kërkojnë nga HPD që t'i japë fund kësaj situate dhe të implementojnë vendimin e HPCC me dëbimin e z. B. Znj. Stanishiç në fakt kishte kërkuar nga HPD më 23 shkurt 2005 që të dëbojë z. B. Pasi ajo nënshkroi formularin përkatës për kërkesën e tillë, më 10 maj 2005, HPD e urdhëroi z. B të lirojë pronën, dhe ankuesit kishin mundësi të marrin në riposedim pronën e tyre më 27 qershor 2005. Në këtë aspekt, Paneli nuk sheh shkelje të së drejtës së ankuesve për respektimin e pronës së tyre. Prandaj, kjo pjesë e ankesës duhet hedhur poshtë si e pabazuar në shikim të parë në kuptim të nenit 3.3 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/12.

74. Ankuesit gjithashtu ankohen për faktin se HPD nuk e ndali z. B nga dëmtimi dhe plaçkitja e pronës së tyre kur ai duhej të largohej. Mirëpo, ashtu siç parashihet në nenin 12.8 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2000/60, HPD nuk është përgjegjëse për ndonjë humbje apo dëmtim të pronës nën administrimin e saj, që i atribuohet shfrytëzuesve të pronës:

> "Drejtoria do të bën përpjeke të arsyeshme për të minimizuar rrezikun e dëmit të cilësdo prone nën administrimin e saj. Drejtoria nuk bart asnjë përgjegjësi për çfarëdo dëmesh të shkaktuara pronës nën administrim apo për humbjet apo dëmin e pjesëve përbërëse të saj."

75. Prandaj, Paneli konsideron se nuk ka bazë për të konstatuar se është shkelur e drejta e ankuesve për mbrojtje të pronës si rezultat i dështimit të HPD për të parandaluar dëmet e shkaktuara pronës së tyre (krahaso Paneli Këshillëdhënës për të Drejtat e Njeriut (PKDNJ), *Zhivkoviç*, nr. 29/08, vendim i 26 nëntorit 2010, §§ 40-41). Paneli thekson në këtë drejtim se ankuesit mund të ndërmarrin veprime kundër z. B, të cilën gjë ata edhe e bënë, me paraqitjen e kallëzimit penal dhe padisë civile kundër atij (shih §§ 42-47 lart dhe, sa i përket padisë civile, §§ 96-100 poshtë).

76. Shqyrtimi i kësaj pjese të ankesës nga pikëvështrimi i nenit 6 të KNDESK, vetëm dhe në kombinim me nenin 2 § 2 të KNDESK, dhe nga pikëvështrimi i nenit 6 § 1 të KEDNJ, nuk shpie në konkludime të ndryshme.

77. Prandaj, Paneli është i mendimit se kjo pjesë e ankesës gjithashtu duhet hedhur poshtë si e pabazuar në shikim të parë.

B. Ankesa lidhur me procedurën që ka të bëjë me padinë civile kundër komunës së Prishtinës, IPVQ-ve dhe UNMIK-ut

a) Parashtresat e palëve

78. Sa i përket ankesës lidhur me vonesën e procedurës që ka të bëjë me padinë kundër komunës së Prishtinës, IPVQ-ve dhe UNMIK-ut, ankuesit u referohen vonesave të ndryshme në procedurën pranë gjykatës komunale të Prishtinës, gjykatës së qarkut në Prishtinë dhe Gjykatës Supreme (shih §§ 29-38).

79. Në këtë aspekt, ata thirren në shkelje të së drejtës së tyre për të marrë vendim brenda një kohe të arsyeshme, të garantuar me nenin 6 § 1 të KEDNJ.

80. PSSP-ja argumenton se padia e ankuesve akoma është në pritje pranë gjykatave. Ankuesit nuk i kanë shterur të gjitha mjetet në dispozicion për dëmshpërblim, dhe prandaj kjo pjesë e ankesës duhet të shpallet e papranueshme.

b) Vlerësim i Panelit

81. Neni 3.1 i Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/12 parasheh që Paneli mund të trajtojë një çështje vetëm pasi të ketë konstatuar se janë ndjekur të gjitha mjetet në dispozicion për rishqyrtim të shkeljes së pohuar.

82. Paneli thekson se ankesa ka të bëjë me kohëzgjatjen e procedurës. Një ankesë e tillë mund të parashtrohet pranë Panelit, edhe para përfundimit të procedurës në fjalë (shih, për sa i përket aplikacioneve drejtuar Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ), *p.sh..*, GJEDNJ, *Biçer kundër Turqisë*, nr. 19441/04, aktgjykim i 20 korrikut 2010, § 20). Paneli në fakt nuk sheh se si procedura që është akoma në pritje mund të kompensojë shkeljen e pohuar të nenit 6 § 1 të KEDNJ që buron nga kohëzgjatja e procedurës (shih GJEDNJ, *Todorov kundër Bullgarisë*, nr. 39832/98, vendim i 6 nëntorit 2003).

83. PSSP-ja nuk ka treguar ndonjë mjet specifik juridik që është në dispozicion për ankuesin sa i përket kohëzgjatjes së procedurës. Sa i përket Panelit, ai nuk sheh ndonjë mjet të tillë juridik.

84. Prandaj, Paneli konkludon se kjo pjesë e ankesës nuk mund të hidhet poshtë për mosshterim të mjeteve në dispozicion në kuptim të nenit 3.1 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/12 (shih PKDNJ, *Mladenoviç*, nr. 61/10, vendim i 6 prillit 2012, §§ 13-15). Paneli nuk e pranon kundërshtimin e PSSP-së.

85. Paneli konsideron se ankesa lidhur me kohëzgjatjen e procedurës ngrit çështje serioze faktike dhe juridike, vendosja e të cilave do të duhej të varet nga shqyrtimi i bazueshmërisë. Prandaj, Paneli konkludon se kjo pjesë e ankesës nuk është e pabazuar në shikim të parë në kuptim të nenit 3.3 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/12.

86. Arsye tjetër për shpalljen e kësaj pjese të ankesës të papranueshme nuk është konstatuar.

C. Ankesa lidhur me aktvendimin e prokurores publike ndërkombëtare të Prishtinës lidhur me kallëzimi penal të ankuesve

a) Parashtresat e palëve

87. Përderisa ankesa ka të bëjë me aktvendimin e prokurores publike ndërkombëtare, të datës 15 shkurt 2007, për kallëzimin penal të ankuesve kundër z. A, z. B dhe z. C (shih § 40 lart), ankuesit theksojnë faktin se prokurorja publike ndërkombëtare e rikualifikoi njërën prej shkeljeve si mbajtje e paligjshme dhe jo si kidnapim. Për rrjedhojë, prokurorja publike ndërkombëtare vendosi se kjo shkelje është e parashkruar, dhe në bazë të kësaj e hodhi poshtë kallëzimin penal lidhur me këtë shkelje. Ankuesit argumentojnë se efekti i rikualifikimit ishte që hetimin e çështjes ta bënte joefektiv.

88. Ankuesit thirren në shkelje të së drejtës së tyre në hetim të paanshëm dhe efektiv, të garantuar me nenin 12 të Konventës kundër torturës dhe trajtimeve apo dënimeve të tjera mizore, johumane apo degraduese, dhe me nenin 2 të KEDNJ. Siç u tha më lart (§ 61), Paneli konsideron se ankuesit gjithashtu mund të konsiderohet se thirren në shkelje të znj. Stanishiç për mjet të efektshëm, të garantuar me nenin 13 të KEDNJ, në kombinim me të drejtën për të mos u trajtuar në mënyrë johumane apo degraduese, të garantuar me nenin 3 të KEDNJ, dhe me të drejtën për të respektuar lirinë e saj, të garantuar me nenin 5 të KEDNJ.

89. PSSP-ja, duke theksuar se aktvendimi i prokurores publike ndërkombëtare nuk iu kishte komunikuar atij, e rezervon të drejtën për të dhënë komente për pranueshmërinë dhe bazueshmërinë e kësaj pjese të ankesës.

b) Vlerësimi Panelit

90. Si çështje preliminare, Paneli thekson se, derisa neni 2 i KEDNJ obligon autoritetet publike që të hetojnë krime të caktuara, kjo dispozitë ka të bëjë vetëm me ndërhyrjet në të drejtën për jetë, *d.m.th.* vrasjet dhe zhdukjet me forcë. Në rastin aktual, kjo dispozitë nuk është e zbatueshme. Mirëpo, një obligim i ngjashëm mund të rezultojë nga neni 3 i KEDNJ, që garanton lirinë nga trajtimi johuman apo degradues. Prandaj, Paneli konsideron se, përderisa ankuesit thirren në shkelje të së drejtës për hetim të paanshëm dhe efikas, ata duhet të konsiderohen se thirren në nenin 3, jo në nenin 2 të KEDNJ, si dhe në nenin korrespondues 12 të Konventës kundër torturës dhe trajtimeve apo dënimeve të tjera mizore, johumane apo degraduese.

91. Shtrohet pyetja nëse aktvendimi i prokurores publike ndërkombëtare përbën “vendim të formës së prerë” kundër të cilit menjëherë mund të parashtrohet ankesë pranë Panelit, apo aktvendimi duhet t’u nënshtrohet mjeteve të tjera për shqyrtim, të cilët ankuesit, në pajtim me nenin 3.1 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/12 (shih § 81 lart), duhet të shterin para se të parashtrojnë ankesë pranë Panelit.

92. Meqë neni 62 (2) i Kodit të Përkohshëm të Procedurës Penale të Kosovës parasheh që pala e dëmtuar ka të drejtë të ndërmarrë apo të vazhdojë ndjekjen penale brenda tetë ditësh nga dita e pranimit të njoftimit për aktvendimin nga prokurori publik se nuk ka bazë për ndërmarrjen e një hetimi apo ndjekje penale për një vepër penale, ka arsye që ky aktvendim të konsiderohet si vendim i cili nuk është i "formës së prerë", për qëllimin e kushtit për shterim të mjeteve në dispozicion.

93. Mirëpo, Paneli konsideron se nuk është e nevojshme të zgjidhet kjo çështje.

94. Në fakt, supozimi se në këtë rast aktvendimi i prokurorit publik përbën "vendim të formës së prerë", kundër të cilit është paraqitur ankesë në Panel (krahaso PKDNJ, *Xhaka*, nr. 55/08, vendim i 15 shtatorit 2011, §§ 26-27), vlen të theksohet se sipas nenit 3.1 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/12, ankesa duhet drejtuar Panelit "brenda një periudhe prej gjashtë muajsh nga dita kur është marrë vendimi i formës së prerë". Në rastin aktual, aktvendimi ishte miratuar nga prokurorja publike ndërkombëtare më 15 shkurt 2007 dhe, siç është paraqitur nga reagimi i ankuesve me një shkresë drejtuar Departamentit të drejtësisë së UNMIK-ut më 1 mars 2007 (shih § 41 lart), ata janë njoftuar për të shpejt pas datës së miratimit të tij. Ankuesit u ankuan për aktvendimin në parashtresat e tyre të datës 4 dhjetor 2008 (shih § 61 lart), që qartazi është jashtë afatit kohor prej gjashtë muajsh (shih PKDNJ, *N.P. dhe të tjerët*, nr. 341/09, vendim i 15 shtatorit 2011, §§ 16-19).

95. Për rrjedhojë kjo pjesë e ankesës është e papranueshme, qoftë për shkak të mosshterimit të mjeteve në dispozicion apo për shkak të paraqitjes jashtë afatit kohor prej gjashtë muajsh.

D. Ankesa lidhur me procedurën që ka të bëjë me padinë civile kundër z. B

a) Parashtresat e palëve

96. Sa i përket ankesës që ka të bëjë me procedurën për padinë civile kundër z. B për kompensim të dëmit të shkaktuar pronës së tyre (shih §§ 45-47 lart), ankuesit argumentojnë se asnjë veprim nuk ishte ndërmarrë nga gjykata komunale në Prishtinë.

97. Siç u tha më lart (§ 62), ankuesit mund të konsiderohet se thirren në shkelje të së drejtës së tyre për të marrë vendim brenda një kohe të arsyeshme, të garantuar me nenin 6 § 1 të KEDNJ.

98. Meqë kjo pjesë e ankesës nuk i është komunikuar PSSP-së, ai nuk ka komentuar për pranueshmërinë e saj.

b) Vlerësimi i Panelit

99. Paneli thekson se kjo pjesë e ankesës është ngritur për herë të parë në parashtresën e ankuesve të datës 23 qershor 2010 (shih § 62 lart). Paneli duhet t'i kthehet nenit 5 të Urdhëresës administrative nr. 17 tetor 2009 për implementimin e Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/12 për themelimin e Panelit Këshillëdhënës për të Drejtat e Njeriut, sipas të cilit "asnjë ankesë drejtuar Panelit Këshillëdhënës nuk do të jetë e pranueshme nëse është pranuar nga Sekretariati i Panelit Këshillëdhënës më vonë se 31 mars 2010". Për rrjedhojë, kjo pjesë e ankesës duhet të shpallet e papranueshme për mungesë të juridiksionit kohor (*ratione temporis).*

100. Për më tepër, Paneli thekson se ankuesit e parashtruan padinë e tyre në gjykatën komunale të Prishtinës më 4 nëntor 2008. Më pak se dy muaj pas paraqitjes së padisë, më 8 dhjetor 2008, EULEX-i mori kontrollin e plotë operacional në fushën e sundimit të së drejtës (shih § 28 lart). Për periudhën e shkurtër gjatë së cilës UNMIK-u ende ishte përgjegjës për punën e gjykatave, kohëzgjatja e procedurës nuk mund të konsiderohet pa arsye e gjatë, dhe prandaj kjo pjesë e ankesës sido që të jetë duhet të shpallet si e pabazuar në shikim të parë. Sa i përket periudhës nga 9 dhjetori 2008, kjo pjesë e ankesës si do që të jetë do të ishte jashtë juridiksionit *ratione personae* të Panelit (krahaso PKDNJ, *Axhançiç*, nr. 310/09, vendim i 16 dhjetorit 2011, §§ 32-34).

E. Ankesa lidhur me procedurën që ka të bëjë me aktakuzën e paraqitur nga z. Stanishiç në gjykatat përkatëse

a) Parashtresat e palëve

101. Për sa i përket ankesës që ka të bëjë me vështirësitë me të cilat është përballur në procedurën lidhur me aktakuzën kundër zotërinjve A, B dhe C (shih §§ 48-55 lart), ankuesit argumentojnë se ka pasur vonesa të paarsyeshme dhe parregullsi procedurale.

102. Siç u tha më lart (§ 63), ankuesit mund të konsiderohet se thirren në shkelje të së drejtës së tyre për gjykim të drejtë dhe për marrjen e një vendimi brenda një kohe të arsyeshme, të garantuar me nenin 6 § 1 të KEDNJ.

103. Meqë kjo pjesë e ankesës nuk i është komunikuar PSSP-së, ai nuk ka komentuar për pranueshmërinë e saj.

b) Vlerësim i Panelit

104. Paneli thekson se kjo pjesë e ankesës është ngritur për herë të parë në parashtresën e ankuesve të datës 23 qershor 2010 (shih § 63 lart). Për arsyen e përmendur lidhur me pjesën paraprake të ankesës (§ 99), kjo pjesë e ankesës duhet të shpallet e papranueshme për mungesë të juridiksionit kohor (*ratione temporis).*

105. Për më tepër, Paneli thekson se z. Stanishiç e parashtroi aktakuzën në gjykatën e qarkut në Prishtinë më 12 janar 2009. Në atë kohë, EULEX-i tanimë kishte marrë kontrollin e plotë operacional në fushën e sundimit të së drejtës (shih § 28 lart). Për rrjedhojë, kjo pjesë e ankesës si do që të jetë do të ishte tërësisht jashtë juridiksionit *ratione personae* të Panelit.

F. Ankesa e përgjithshme për marrëveshjen e fshehtë në mes të gjykatave dhe elementeve kriminale

a) Parashtresat e palëve

Sa i përket ankesës që ka të bëjë me pohimin për marrëveshjen e fshehtë në mes të autoriteteve gjyqësore dhe ish udhëheqësve të UÇK-së, që aktualisht mbajnë pozita të rëndësishme në institucionet e Kosovës, ankuesit argumentojnë se autoritetet gjyqësore

ndjekin qëllimin e parandalimit të tyre dhe të familjeve të tjera të fuqishme serbe që të kthehen në pronat e tyre dhe të rifillojnë veprimtarinë e tyre afariste.

106. Siç u tha më lart (§ 0), ankuesit mund të konsiderohet se thirren në shkelje të së drejtës së tyre për një tribunal të pavarur dhe të paanshëm, të garantuar me nenin 6 § 1 të KEDNJ, vetëm dhe në kombinim me ndalimin e diskriminimit, të garantuar me nenin 14 të KEDNJ.

107. Meqë kjo pjesë e ankesës nuk i është komunikuar PSSP-së, ai nuk ka komentuar për pranueshmërinë e saj.

b) Vlerësimi i Panelit

108. Paneli e ka parasysh shqetësimin e ankuesve për sa i përket pavarësisë së gjyqësorit në Kosovë, veçanërisht gjykata komunale dhe ajo e qarkut të Prishtinës në rastet e tyre. Mirëpo, që një ankesë të shpallet e pranueshme, ajo duhet të mbështetet me dëshmi në shikim të parë.

109. Në rastin aktual, ankuesit e bazojnë ankesën e tyre të përgjithshme ekskluzivisht në mënyrën se si autoritetet gjyqësore trajtuan dhe vazhdojnë të trajtojnë rastet e tyre. Derisa këto çështje padyshim se mund të ngritën, Paneli konsideron se ndodhitë procedurale dhe vendimet e marra nuk mjaftojnë për të dëshmuar se autoriteteve gjyqësore u mungon pavarësia e nevojshme.

110. Në bazë të elementeve të paraqitura nga ankuesit, Paneli nuk mund të vijë në asnjë konkludim tjetër përveç se në atë se nuk ka bazë të mjaftueshme për të konstatuar shkeljen e të drejtave në të cilat thirren ankuesit.

111. Për rrjedhojë, kjo pjesë e ankesës duhet të shpallet e papranueshme si e pabazuar në shikim të parë në kuptim të nenit 3.3 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/12.

PËR KËTO ARSYE,

Paneli unanimisht,

- E SHPALL TË PRANUESHME ANKESËN LIDHUR ME TË DREJTËN PËR VENDIM GJYQËSOR BRENDA NJË KOHE TË ARSYESHME (NENI 6 § 1 I KONVENTËS EVROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT), PËR SA I PËRKET PROCEDURËS SË INICIAUR MË 2004 NË GJYKATËN KOMUNALE TË PRISHTINËS;

- E SHPALL TË PAPRANUESHME PJESËN TJETËR TË ANKESËS.

Andrey ANTONOV
Zyrtare ekzekutiv

Paul LEMMENS
Kryetar